



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.33.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
GRAÇANICËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Graçanicës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Igballe Halili dhe anëtarëve të ekipit Arnisa Aliu dhe Abdurrahmon Berbatovci, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Zukë Zuka.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	19
5 Qeverisja e mirë.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	24
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	26
Shtojca III: Letër e Konfirmimit	36

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Graçanicës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 22/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Theksim i Çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se, vlera e pasurive jo financiare, e shpalosur në PFV nuk është e saktë. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos regjistrimit të tokave dhe objekteve në regjistrin e pasurisë si dhe gabimet në regjistrimin e pasurive të blera në vitin 2017 (mos regjistrimi i tyre ose regjistrimi i dyfishtë).

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e PFV-ve. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Graçanicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Komuna ka arritur të identifikoj pasurinë komunale, mirëpo ende nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e të gjitha tokave dhe objekteve që t'i regjistrojë në regjistrin e pasurisë, si dhe të bëjë inventarizimin e pasurive në fund vit; dhe
- Komuna nuk kishte bërë regjistrimin e gjithë pasurisë së saj, ngase në pesë¹ raste, pagesat për pasuritë në vlerë 119,847€ nuk janë regjistruar në SIMFK. Ndërsa në pesë² raste tjera pasuritë kapitale ishin mbivlerësuar për 169,061€, si pasojë e regjistrimeve të dyfishta. Po ashtu, pasuritë jo kapitale (nën 1,000€) ishin nënvlerësuar për 57,217€.

Dobësitë e prezantuara tregojnë se komuna kishte pasaktësi në regjistrat e pasurive. Këtë e ka shkaktuar mungesa e kontrolleve në menaxhimin dhe raportimin e tyre.

Opinionin jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Si çështje kyçe të auditimit përmendim faktin se:

- Llogaritë e arkëtueshme janë paraqitur në pasqyrat financiare në vlerë prej 2,786,417€, mirëpo nuk kishte shpalosje të duhura, që mund të konsideroheshin për nevoja të planifikimeve buxhetore të burimeve vetjake. Llogaritë e akumuluarra përfshijnë edhe të arkëtueshmet e bartura prej më shumë se 10 viteve, që mundësia e inkasimit është minimale; dhe
- Komuna e ka prezantuar në PFV, listën e detyrimeve kontingjente të cilat ishin të përcaktuara më vlerë, mirëpo një pjesë të konsiderueshme e detyrimeve kontingjente tjera të pa përcaktuara me vlerë (të prezantuara në raportin e avokatit komunal), nuk janë shpalosur në PFV. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të palëve paditëse, organizata pritet të ketë vështirësi financiare.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Graçanicës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga

¹ Tri pagesa "Ndërtimi i objekteve sociale në Suvi Do Faza II" në total 100,483€, "Rregullimi i ngrohjes qendrore në shkollën fillore në Batus dhe Preoc" në vlerë 9,560€ dhe "Ndërtimi i objektit të ambulancës në Llapna Sell" në vlerë 9,804€; si dhe

² Katër pagesa "Rehabilitimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale në Komunën e Graçanicës" total 142,761€, dhe "Rindërtimi i rehabilitimit dhe zgjerimit të rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizime" në vlerë 26,300€.

mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalesjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe

-
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmuajore me kohë, dhe planin e prokurimit.

Në PFV e dorëzuara në MF ishin të nevojshme disa korrigjime tek shpalosjet e pasqyrave financiare si:

- Obligimet e papaguara për “Shërbimet e pastrimit “ në vlerë prej 13,494€, ishin nënvlerësuar;
- Detyrimet kontingjente të shpalosura ishin nënvlerësuar për 1,822,790€; dhe
- Llogaritë e arkëtueshme për tatimin në pronë ishin mbivlerësuar për 17,006€, ndërsa taksat e veprimtarisë së bizneseve nuk ishin shpalosur fare në draft PFV.

Gjatë kohës së auditimit komuna ka vërejtur mos shpalosjen e drejtë të çështjeve të lartë shënuara në PFV-të dhe ka bërë korrigjimet e nevojshme.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryetari, duhet të siguroj se është bërë një analizë për t’i përcaktuar shkaqet e theksuara në opinionin e auditimit dhe të çështjet kyçe. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t’i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t’i eliminuar gabimet në shpalosjen e saktë të vlerës së pasurive, detyrimeve kontingjente dhe llogarive të arkëtueshme në PFV.

Më tutje, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve 2018, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me MFK-në, pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në komunë. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë si dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Në kontestin e sistemit financiar, kontrollet mbi subvencione në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit, menaxhimi i llogarive të arkëtueshme dhe menaxhimi i pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	7,134,075	7,776,688	6,694,513	6,172,301	6,153,879
Granti i Qeverisë -Buxheti	5,433,592	5,620,593	5,346,845	4,685,978	4,541,220
Të bartura nga viti paraprak ⁴ -	-	378,040	284,851	409,089	325,698
Të hyrat vetjake ⁵	1,700,483	1,700,483	985,564	1,033,288	1,247,563
Donacionet e Brendshme	-	-	-	-	39,398
Donacionet e jashtme	-	77,572	77,253	43,946	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 642,613€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme në vlerë 77,572€ për projektin “Përmirësimi i ndriçimit rrugor”, të hyrave të

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁴ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁵ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

bartura nga viti paraprak në vlerë 378,040€, si dhe i rritjes së aplikuar me vendime të Qeverisë në vlerë prej 187,001€.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar 86% të buxhetit final, me një rënie prej 8% krahasuar me vitin 2016 që kishte një realizim prej 94%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	7,134,075	7,776,688	6,694,513	6,172,301	6,153,879
Pagat dhe Mëditjet	2,623,151	2,702,542	2,702,541	2,645,027	2,558,015
Mallrat dhe Shërbimet	602,120	807,106	774,503	936,115	777,723
Shërbimet komunale	150,000	150,000	139,702	126,106	140,458
Subvencionet dhe Transferet	180,859	204,618	183,451	281,574	297,053
Investimet Kapitale	3,577,945	3,912,422	2,894,316	2,183,479	2,380,630

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

Me vendimet e Qeverisë kishte rritje te kategoria e pagave dhe mëditjeve për 79,391€ dhe te kategoria e investimeve kapitale për 107,611€ për projektin “Ndërtimi i spitalit në Graçanicë”. Ndërsa ndryshimet (rritjet) tjera nëpër kategori, janë prej alokimit të mjeteve nga të hyrat vetjake të bartura si: te mallrat dhe shërbimet 204,986€, subvencionet 23,759€, dhe te investimet kapitale për 149,294€. Kategoria e investimeve kapitale ishte rritur edhe nga donacionet e jashtme për 77,572€.

Niveli i ekzekutimit të buxhetit për kategorinë e investimeve kapitale, nuk ishte efektiv (74%). Kjo ka ndodhur për shkak të vonesave në zbatim të disa projekte të filluara para 2017, si dhe një projekt në vitin 2017, ndërsa në kategoritë tjera kishte trend pozitiv të ekzekutimit të buxhetit, mbi 90%.

Çështja 2 – Niveli i ulët i realizimit të buxhetit si dhe keq-klasifikim i shpenzimeve

E gjetura

Procesi i menaxhimit të buxhetit nga komuna ka qenë sfiduese. Marr parasysh periudhën fiskale, një përqindje e madhe e shpenzimeve është realizuar në dhjetor të 2017. Në anën tjetër, ka ngecje në realizimin e projekteve kapitale e cila reflekton edhe në realizimin e buxhetit. Çështje e rëndësishme është edhe ekzekutimi i buxhetit nga pagesat direkte të Thesarit sipas nenit 39.2 të LMFPP në vlerë 490,852€, për shkak se komuna ka hyrë në obligime pa zotime të mjaftueshme të mjeteve.

Pagesa për “Pastrimin, mirëmbajtjen e rrugëve” në vlerë 44,799€, ishte bërë gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale derisa natyra e shërbimit ishte e mallrave dhe shërbimeve dhe si e tillë ishte buxhetuar. Ndërsa në tri pagesa tjera në vlerë 106,282€⁶, kodet ekonomike ishin evidentuar gabimisht brenda kategorisë së investimeve kapitale.

Rreziku

Dobësitë në menaxhimin e projekteve, rezultojnë me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion, si dhe reduktojnë efektivitetin e planeve të shpenzimeve të komunës. Ndërsa, pagesat direkte nga Thesari, janë domethënëse për buxhetin e komunës dhe ndikojnë në lëkundje të bilancit buxhetor. Kjo rrit rrezikun për pagesa jashtë kodeve të planifikuara dhe mos realizimin e projekteve për shkak të ridestinitimit të shpenzimeve buxhetore.

Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës.

Rekomandimi 2

Kryetari, duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfillët të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Përveç kësaj duhet të përmirësohet menaxhimi i projekteve kapitale për tu siguruar se ato përfundojnë sipas afateve të kontraktuara dhe me cilësi optimale. Ndërsa, planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2017 ishin në vlerë 1,644,554€. Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, taksat administrative, etj. Gjithashtu komuna kishte edhe të hyra indirekte të mbledhura nga dënimet e policisë dhe gjobat në vlerë 25,020€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,700,483	1,700,483	1,644,554	1,354,272	1,690,738
Total të hyrat	1,700,483	1,700,483	1,644,554	1,354,272	1,690,738

⁶“Rekonstruimi i terreneve sportive pranë shkollave në komunën e Graçanicës” në vlerë 23,579€,”Ndërtimi i objektit të ambulantes në Llapnasell” në vlerë 9,803€, dhe “Furnizim me minibus për transportin e nxënësve” në vlerë 72,900€.

Komuna, kishte arritur që të inkasoj 96% të te hyrave të planifikuara. Krahasuar me vitin paraprak të hyrat janë rritur për 304,146€, ose 21%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) kontrolli i pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave, b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, si dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Çështja 3 – Marrëveshjet kontraktuale dhe angazhimi i stafit në afat të caktuar

E gjetura Komuna, kishte punësuar katër punëtorë të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta, ku kontrata ju vazhdohet çdo gjashtë muaj. Për më tutje, komuna për këta të punësuar nuk kishte aplikuar procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit ashtu siç parashihet me aktet e përcaktuara ligjore.

Rreziku Angazhimi pa procedura si dhe tej zgjatja e kontratave për shërbime të veçanta, rrit rrezikun që të angazhohen personat jo kompetent për pozitat përkatëse. Kjo mund të rezultojë në mos efikasitet operacional dhe mosarritje të objektivave të organizatës.

Rekomandimi 3 Kryetari, duhet të sigurojë një plan të arsyeshëm për punët që ndërlidhen me shërbimet me marrëveshje të veçanta. Po ashtu, nevojat shtesë për punëtorë me pozita të rregullta, t'i trajtoj me organet përkatëse dhe të gjendet zgjidhja e pranuar. Në këtë mënyrë do të mënjanoen kërkesat për kontrata për shërbime të veçanta që mund të kalojnë periudhën e përcaktuar.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit bëhet në bazë të rregullores së brendshme me nr.2769/16 e cila bazohet në ligjin për vetëqeverisje lokale si dhe në statusin e komunës. Menaxhimi i personeli në përgjithësi ishte i duhur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 957,106€ (përfshirë shërbimet komunale). Prej tyre ishin shpenzuar 914,205€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material harxhues, shërbime, mirëmbajtje dhe shërbime komunale.

Çështja 4 – Monitorimi jo i duhur i marrëveshjes

E gjetura Komuna, kishte lidhur marrëveshjen me KRM “Pastrimi” sh.a, për ofrimin e shërbimeve komunale “Bartja e mbeturinave” si dhe “Mirëmbajtja e higjenës publike”. Sipas marrëveshjes, shpenzimet mujore për kryerjen e këtyre dy shërbimeve arrijnë vlerën 25,067€.

Gjatë testimit të lëndëve, identifikua se raporti për shërbimet e kryera ishte i mangët, dhe i hartuar nga një zyrtar për të cilin nuk kishte ndonjë vendim lidhur me mbikqyrjen dhe mbarëvajtjen e marrëveshjes.

Rreziku Marrëveshjet e tilla pa emërtim të mbikqyresit dhe monitorim nga ana e komunës, paraqesin rrezik që mjetet e dhëna të mos arrijnë qëllimin e caktuar, dhe zvogëlon sigurinë që marrëveshja është realizuar konform kushteve dhe specifikave të parapara.

Rekomandimi 4 Kryetari, duhet të emërtojë mbikqyresit dhe të sigurojë se është pranuar një raport i detajuar mbi shërbimet e kryera në mënyrë që të shtojë sigurinë tek menaxhmenti se marrëveshjet po realizohen konform kushteve të kontraktuara.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 204,618€. Prej tyre, në vitin 2017 ishin shpenzuar 183,451€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e entiteteve jo publike për t'i mbështetur aktivitetet sportive-kulturore, rastet sociale, subvencionimet në bujqësi, etj.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,912,422€. Prej tyre, në 2017 ishin shpenzuar 2,894,316€. Ato kanë të bëjnë me investime në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe objekteve të ndryshme kapitale. Në planin e prokurimit ishin planifikuar të realizohen 28 projekte kapitale prej të cilave ishin realizuar vetëm 17, derisa disa projekte tjera ishin në proces të zbatimit. Arsyeja për mos realizimin e të gjitha projekteve kapitale ishte vonesa nga drejtoritë kërkuese për të përgatitur dokumentacionin teknik të projekteve individuale.

Çështja 5 – Mangësitë në procesimin e pagesave

- E gjetura** Në procesimin e tri⁷ pagesave në vlerë prej 154,907€, fillimisht ishin pranuar faturat, ndërkaq më vonë ishte bërë zotimi i mjeteve, kërkesa për shërbime dhe urdhërblerja.
- Pagesa për “Furnizimin e pajisje mjekësore” në vlerë 36,473€, nuk ishte paguar sipas afatit të paraparë brenda 30 ditëve siç parashihet me rregullën financiare.
- Rreziku** Mos ndjekja e procedurave të duhura të kontrollit, mund të rezultojë edhe me pagesa potencialisht të parregullta dhe humbje financiare. Mos pagesa e faturave sipas afatit të përcaktuar, mund të sjellë komunën në vështirësi financiare.
- Rekomandimi 5** Kryetari, duhet të forcojë kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPN-në, dhe me rregullat e Thesarit. Po ashtu, duhet të rishikoj në mënyrë sistematike, arsyen e mos pagesës së faturave në baza mujore për t’i eliminuar të gjitha obligimet brenda afatit ligjor.

Çështja 6 - Mos zbatimi i planit dinamik për realizimin e punimeve

- E gjetura** Te kontrata “Rikonstruktimi i terreneve sportive pranë shkollave në Komunën e Graçanicës” me vlerë 30,626€ e nënshkruar në muajin gusht 2017, ka ngecje në realizim të punëve. Sipas kontratës punët ishin paraparë të fillojnë tri ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe të përfundonin brenda dy muajve. Deri në periudhën e terenit (mars 2018), pas shtatë muajve ishin realizuar vetëm dy situacione, derisa situacioni i tretë ishte në proces. Sipas diskutimeve me menaxherin e kontratës, kjo kishte ndodhur si pasojë e kushteve atmosferike, mirëpo sipas ditarit të punëve, ishte specifikuar se nuk ishte punuar vetëm 14 ditë.
- Rreziku** Menaxhimi respektivisht realizimi jo efektiv i projekteve kapitale mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave vjetore dhe strategjike të komunës dhe/apo pamundësinë e mbulimit të detyrimeve me fondet aktuale.
- Rekomandimi 6** Kryetari, duhet të sigurojë që planifikimi i projekteve i nënshtrohet një analize reale të kapaciteteve të komunës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare dhe kërkesat ligjore. Kontrollet në planifikimin dhe menaxhimin e projekteve duhet të forcohen për të tejkaluar sfidat e identifikuara me qëllim të arritjes së objektivave të komunës brenda afateve kohore dhe fondeve të planifikuara.

⁷ “Ndërtimi i spitalit” në vlerë 107,611€, “Furnizim me material ndërtimor” në vlerë 10,823€ dhe “Furnizimi me pajisje mjekësore” në vlerë 36,473€.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Udhëzuesi kryesor në këtë fushë është rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

Çështja 7 – Mos aplikim i sistemit e-pasuria

E gjetura	<p>Sipas rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuritë kapitale me vlerë nën 1,000€ dhe stoqet evidentohen në sistemin e-pasuria.</p> <p>Komuna nuk aplikonte sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria) që t'i regjistrojë të gjitha pasuritë nën 1,000€, përfshirë asetet, materialet shpenzuese, etj. Për këtë qëllim komuna mban një listë të brendshme (regjistër në Excel).</p>
Rreziku	<p>Mos aplikimi i sistemit e-pasuria vështirëson menaxhimin adekuat të pasurisë dhe rrit rrezikun e gabimeve gjatë evidentimit të pasurisë si dhe përlogaritjes manuale të zhvlerësimit. Kjo po ashtu mund të rezultojë me mos përmbushje të kërkesave të kontabilitetit dhe raportimit financiar të pasurisë.</p>
Rekomandimi 7	<p>Kryetari, duhet të sigurojë që të marrë veprimet e nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhimin dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Me pas të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e komunës të cilët do të përcaktohen përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi.</p>

3.9 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta janë fond i vogël i parave që mbahet në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësisë më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.10 Të arkëtueshmet

Komuna ka vendosur një sistem të kontrollit të brendshëm që mbikëqyrë procesin e llogarive të arkëtueshme duke e menaxhuar përmes drejtorive përkatëse. Megjithatë edhe më tutje sistemi i kontrollit duhet të forcohet, për të parandaluar rritjen e të arkëtueshme nga viti në vit dhe vlera e tyre të ulet në një shkallë të pranueshme.

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2017 ishin në vlerë prej 2,786,417€, në këtë shumë janë të përfshira “Tatimi në pronë”, “Dënimet e inspeksionit”, “Shpronësimi i tokës”, “Qiraja” dhe “Taksa në veprimtari”.

Për tatimin në prone, gjatë vitit 2017 komuna kishte faturuar 604,568€, prej të cilave (pa borxhe, kamata, ndëshkime) ishin mbledhur 345,420€, apo 57%. Në anën tjetër, komuna kishte arritë ta bëjë ri-anketimin e ndërtesave për tatimin në pronë në përputhje me legjislacionin.

Çështja 8 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

E gjetura Komuna nuk ka të vendosur procedura të brendshme për arkëtimin, regjistrimin si dhe raportimin e drejtë të llogarive të arkëtueshme.

Trajtimi i të arkëtueshmeve, rritja e tyre nga viti në vit vazhdon të mbetet sfida edhe më tutje. Mungesa e një analize për të identifikuar/nxjerrë shkaktarët e mos mbledhjes së të arkëtueshmeve ka rezultuar me një inkasim të dobët të tyre.

Po ashtu, në tre raste, është vërejtur se kartelat individuale të tatimpaguesit në sistemin e ProTax-it, nuk ishin azhurnuar me kohë.

Rreziku Mungesa e veprimeve të mjaftueshme apo mangësitë në procesin për inkasim të arkëtueshmeve mund të mos i inkurajon borxhlinjtë tjerë që t'i paguajnë obligimet e tyre me kohë. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson mbledhjen e tyre. Mos azhurnimi me kohë i sistemit Protax për tatimin e paguar, mund të të ndikoj në informata jo të saktë për menaxhmentin.

Rekomandimi 8 Kryetari, duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e llogarive të arkëtueshme, si dhe të jenë më efikas në procesin e arkëtimit të tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.

3.11 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 156,562€. Krahasuar me vitin 2016 ku obligimet ishin 413,600€, mund të konkludojmë se ato janë menaxhuar më mirë në vitin 2017.

Obligimet e prezantuara janë bartur për t'u paguar në vitin vijues.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të komunës ka rezultuar në 21 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, shtatë rekomandime janë zbatuar, nëntë ishin në proces ndërsa pesë nuk janë zbatuar ende. Ndërkaq, në vitin 2015 ishin dhënë 19 rekomandime, prej të cilave tri ishin zbatuar, 12 rekomandime janë në procese të zbatimit ndërsa katër nuk ishin trajtuar ende nga ana e menaxhmentit.

Kryetari i Komunës ka shqyrtuar raportin e auditimit për vitin 2016 në Asamblenë Komunale, mirëpo nuk ka prezantuar progresin lidhur me zbatimin e planit të veprimit për rekomandimet e auditimit para se PFV-të të dorëzohen në MF-së.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 9 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** Komuna, ka hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo kjo nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i tyre monitorohet formalisht. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim pritet të identifikohen dhe adresohen.
- Si rrjedhojë, disa prej rekomandimeve si: mangësitë në prezantimin e pasurisë, mos hartimi i regjistrit të rreziqeve, mos inspektimi i objekteve/lejeve ndërtimore, si dhe rritja e llogarive të arkëtueshme janë të gjetura të përsëritura në raportet e auditimit në vitet e fundit.
- Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontroleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.
- Rekomandimi 9** Kryetari, duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha Organizatat Buxhetore, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në qeverisjen lidhur me aktivitetet operacionale dhe financiare në komunë ende mbesin fusha ku nevojiten veprime të rëndësishme. Vëmendje e shtuar e menaxhmentit nevojitet në proceset për adresimin e rekomandimeve të auditimit dhe proceseve të menaxhimit të rrezikut. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit nuk janë të vendosura ndërsa Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

Komuna kishte plotësuar pyetësorin e vet-vlerësimit (pyetësori ishte mbështetur me dëshmi) dhe kishte një situatë më pozitive në raport me vitin paraprak.

Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit socio-ekonomik lokal 2017-2021 konsiderohet se është e vendosur pjesërisht nga ana e komunës, për arsye se strategjia ishte draft e cila nuk është miratuar, dhe si e tillë nuk ka mundur të gjej zbatim nga ana e komunës. Po ashtu, komuna ka edhe plane tjera funksionale si: plani për integritet 2016-2020, Programi i mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë 2014-2029 (në bashkëpunim me UN HABITAT dhe SDC), Plani operativ i punës për 2017, Plani operativ i Inspektionit 2017 etj.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësitë e Auditimit të Brendshëm (NJAB),) përbëhet nga dy auditor. Në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2017, ishin planifikuar dhe realizuar 11 auditime. Planet ishin bërë në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve.

Komiteti i Auditimit, si organ i pavarur dhe këshillëdhënës për menaxhmentin i cili thirret për të ndihmuar kontrollin e brendshëm në komune, gjatë vitit 2017 kishte mbajtur gjashtë takime, ku ishin diskutuar gjetjet dhe rekomandimet e NJAB-së si dhe kishte përgatitur një raport gjithë përfshirës në fund të vitit duke ju drejtuar menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Çështja 10 - Niveli i ultë i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së

E gjetura NJAB në 11 raportet e auditimit kishte dhënë gjithsej 57 rekomandime se si menaxhmenti të përmirësojë funksionimin e kontrollit të brendshëm. Menaxhmenti nuk kishte hartuar plane të veprimit për të gjitha raportet. Si rrjedhojë niveli i zbatimit të rekomandimeve ishte i ulët. Nga gjithsej rekomandimet e dhëna, tetë ishin zbatuar, 31 ishin në proces të zbatimit ndërsa pjesa tjetër nuk ishin zbatuar.

Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet të zbatohen nga komuna me kohë.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve zvogëlon efikasitetin dhe ndikimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm në përmirësimin e qeverisjes së përgjithshme.

Rekomandimi 10 Kryetari, duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe të marrë të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara ende kërkojnë përmirësim.

Çështja 11 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerr në pah se angazhimet e përgjithshme të kontrolleve kërkojnë përmirësim, në veçanti në lidhje me realizimin e buxhetit për investime kapitale, regjistrimin dhe raportimin e pasurive si dhe menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Komuna, ende nuk ka hartuar regjistrin e rreziqeve. Ajo, ka marrë iniciativë për të punuar në hartimin e regjistrit të rreziqeve, mirëpo ende nuk ka rezultate/veprime konkrete. Kjo përbën mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e rreziqeve.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë.

Rekomandimi 11 Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për mos adresimin e rreziqeve domethënëse lidhur me klasifikimin e shpenzimeve dhe plotësinë e pasurive, e që ka rezultuar me Kualifikim të Opinionit dhe me Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të siguruar një vlerësim të saktë të pasurive kapitale dhe klasifikim adekuat të shpenzimeve. Ky proces duhet të monitorohet formalisht nga Kryetari i Komunës.		Për sa i përket pasurive është bërë një hap përpara lidhur me identifikimin e pasurive, mirëpo nuk është arritur ende të vlerësohen pasuritë dhe të kemi siguri se vlera e pasurive neto është e saktë. Sa i përket klasifikimit të shpenzimeve ka një progres krahasuar me vitet paraprake.	
1.4 Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF-ve 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse në draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të analizojë shkaqet pse nuk është vendosur një proces formal dhe i monitoruar për zbatimin e planit të veprimit dhe diskutimin e raportit në Kuvendin Komunal. Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit për vitin 2015 përcakton saktë afatet kohore për adresim të rekomandimeve të bëra nga AP dhe stafin përgjegjës, me fokus fillestar në çështjet më të rëndësishme të ngritura nga auditimi. Raporti i auditimit duhet të diskutohet në Kuvendin Komunal dhe zbatimi i planit të veprimit duhet të monitorohet në baza të rregullta mujore nga Kryetari i Komunës.		Komuna kishte hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë mbetur të pa zbatuara ose në proces të zbatimit.	
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive duke ndërmarrë veprimet adekuate për vendosjen e aranzhimeve të kërkuara aty ku ende nuk janë vendosur. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Auditimi i brendshëm mund të luaj rol kyç në këtë aspekt.		Krahasuar me vitet paraprake pyetëtori i vetëvlerësimit është i një cilësie më të mirë, pasi që në këtë pyetësorë janë përfshirë edhe disa komponentë siç është psh. menaxhimi i listës së rreziqeve, megjithatë hartimi i saj nuk ka ndodhur.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.		Përgjegjësia është deleguar tek drejtorët, megjithatë, mbetet të përcjellën veprimet konkrete.	
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.		Vërehet se ka pasur raportime por jo gjithëherë i mbështetur me procesverbale të takimeve.	

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm. Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim të vazhdueshëm dhe pro-aktiv me Komitetin e Auditimit. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë në mënyrë kritike burimet dhe planet e auditimit të brendshëm (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe posedojnë burimet e nevojshme që t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm.		Menaxhmenti vetëm për një numër të caktuar të raporteve ka bërë planin e veprimit.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore të rishikohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Këtij aktiviteti duhet t'i paraprijë një proces i mirëfilltë i planifikimit, përcaktimit të objektivave dhe ndërlidhjes së tyre me buxhetin e komunës.		Edhe pse janë marrë hapat drejt planifikimit më të mirë, ende procesi i planifikimit nuk është në një nivel të kënaqshëm. Ngase, ende ekzistojnë pagesa direkte nga Thesari dhe shpenzimet për IK ende mbesin sfidë për komunën.	
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet t'i analizojë arsyet pse kontrollet për parandalimin e dobësive të lartë cekura nuk kanë funksionuar dhe t'i identifikojë veprimet e nevojshme për të siguruar që kontrollet e nevojshme ekzistojnë dhe funksionojnë gjatë tërë proceseve për të arritur vlerën e duhur për para. Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha punët duhet të kryhen vetëm atëherë kur ekzistojnë projektet dhe përmes procedurave të përcaktuara me ligj dhe vetëm për investimet që janë të aprovuara brenda kompetencave komunale.		Krahasuar me vitin 2015 janë shtuar kontrollet në eliminimin e dobësive. Te gjeturat e përmendura nuk janë përsëritur, më përjashtim në vonesave në realizimin e projekteve.	

3.4 Prokurimi	Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet për planifikimin e duhur të projekteve kapitale dhe të sigurojë që të gjitha prokurimet të kryhen në pajtim me kërkesat e ligjeve dhe udhëzimeve relevante. Një vlerësim objektiv dhe gjithëpërfshirës duhet të kryhet gjatë përgatitjes së planit të prokurimit, për të siguruar që të gjitha projektet janë të përfshira.			Nuk janë marrë masa.
3.5.1 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha marrëveshjet e komunës të jenë në pajtim me ligjet në fuqi dhe që procesi i rishikimit të kësaj marrëveshje të përfundojë brenda një afati minimal në mënyrë që obligimet nga marrëveshja të mos e rëndojnë buxhetin e komunës. Kryetari, po ashtu, duhet t'i analizojë shkaqet e vonesave të pagesave që kanë rezultuar me ekzekutim nga ana e Thesarit dhe të sigurojë që të gjitha obligimet e komunës do të kryhen brenda afateve të caktuara ligjore.		Sa i përket pagesave të faturave ka progres, pasi që vetëm një rast është identifikuar. Megjithatë, ende ekzistojnë pagesa direkte nga Thesari të cilat komuna i ka neglizhuar për arsye të mos zotimit të mjeteve me kohë.	
3.5.1 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet t'i identifikojë arsyet pse kërkesat e LPP-së nuk janë zbatuar gjatë lidhjes së këtyre marrëveshjeve dhe t'i forcojë kontrollet për të siguruar zbatimin e plotë të këtyre kërkesave. Të gjitha pagesat për punë/shërbime duhet të kryhen vetëm pasi të ekzistojnë proceset e rregullta të prokurimit dhe pasi të jenë përmbushur kërkesat e rregullave financiare për shpenzimin e parasë publike.		Nuk janë vërejtur pagesa që janë në kundërshtim me LPP-në mirëpo ende ka mangësi në përcaktimin e mbikëqyrësit të projekteve.	
3.5.2 Kompensimet (paga dhe mëditje)	Kryetari duhet ta rishikojë strukturën aktuale të vendeve të punës dhe t'i përcaktojë nevojat e çdo programi të komunës për burime njerëzore. Kryetari, në bashkëpunim me MAP dhe MF, duhet të sigurojë që çdo punonjës është i sistemuar sipas përshkrimit të vendit të punës brenda programeve të caktuara komunale.		Komuna ka filluar të sistemojë punonjësit sipas përshkrimit të vendeve të punës, mirëpo ende kemi identifikuar raste të sistematizimit të stafit jashtë procedurave të rregullta.	

3.5.2 Kompensimet (paga dhe mëditje)	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha vendimet me efekt juridiko-financiar të kenë bazë të vlefshme ligjore dhe të hyjnë në fuqi vetëm pas shqyrtimit dhe miratimit nga zyra ligjore e komunës.	Po		
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet ta iniciojë ridraftimin e rregullores për të përcaktuar numrin deri në sa herë mund të subvencionohet brenda vitit i njëjti përfitues. Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të sigurojë që subvencionet ndahen në përputhje me rregullat duke aplikuar kontrolle shtesë në monitorimin e shpenzimit të fondeve me qëllim të rritjes së kredibilitetit tek qytetarët dhe arritjes së objektivave të përcaktuara.	Po		
3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari duhet të sigurojë që do të merren masa të menjëhershme për të vendosur kontrolle efektive për menaxhimin e të gjitha të hyrave nga institucionet komunale, përfshirë: inkasimin, deponimin në llogarinë e komunës dhe raportimin e tyre. Zbatimi efektiv i kontrolleve duhet të monitorohet formalisht në baza të rregullta nga Kryetari.	Po		
3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet lidhur me inkasimin e të hyrave në përgjithësi për të siguruar që ato janë në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi. Kryetari, me theks të veçantë, duhet të sigurojë që ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore t'i paraqitet Kuvendit Komunal vetëm pas pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.		Për një pjesë të konsiderueshme ishte marrë pëlqim nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, megjithëse ende kishte lënde të pa procesuara. Për me tepër në disa raste edhe Ministria ishte vonuar në dhënien e pëlqimeve.	

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të analizojë arsyet për përsëritjen e dështimit të punës së komisioneve për inventarizim dhe vlerësim të pasurive për vitin 2015. Kryetari duhet të emërojë një grup punues me mision të veçantë për identifikimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë së komunës para përfundimit të vitit 2016. Puna e këtyre komisioneve duhet të monitorohet sistematikisht nga Kryetari, dhe sipas nevojës të ndërmerren veprime shtesë për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e vlerave të pasurive në PFV-të e vitit 2016.			Nuk janë marrë masa.
3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet t'i analizojë arsyet e trendit të rritjes së të arkëtueshmeve nga tatimi në pronë dhe t'i forcojë kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2 Pasqyrat financiare	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjeve. Njëherit, të ndërmerr veprime në adresimin e shkaqeve për keqklasifikimin e shpenzimeve, mos vlerësimin e pasurisë së evidentuar si pasuri e komunës, si dhe të nënvlerësimit të llogarive të arkëtueshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse ndaj draft PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		Komuna e Graçanicës e ka bërë regjistrimin e pasurisë së saj në tërësi, por nuk e ka vlerësuar vlerën e pasurisë të cilën tashmë e posedon, si dhe nuk është kryer regjistrimi i plotë i pasurisë nën vlerën 1,000 €. <p>Sa i përket klasifikimit nëpër kode ekonomike, ka progres, megjithëse edhe në këtë raport ne kemi identifikuar disa parregullsi. Ndërsa llogaritë e arkëtueshme fillimisht ishin nënvlerësuar, mirëpo pas korrigjimit të PVF-ve ato janë prezantuar drejtë.</p>	

2.1 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin e plotë të rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, dhe nga ta të pranoj raporte të rregullta mbi progresin e arritur në zbatimin e rekomandimeve.		Komuna kishte hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë mbetur të pa zbatuara ose në proces të zbatimit.	
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit	Kryetari duhet të siguroj se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës së rreziqeve, forcimin e çështjeve tjera menaxhuese dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive.		Janë ndërmarrë hapat, por ende ka hapësirë për përmirësim.	
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari duhet të siguroj hartimin e një strategjie të përgjithshme zhvillimore, si dhe të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.		Është hartuar draft strategjia e përgjithshme, mirëpo nuk është miratuar në kuvend.	
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të siguroj se cilësia e kontrolleve dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të rishikohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar se janë vendosur kontrole të përshtatshme, në fushat ku janë identifikuar dobësitë.		Ka përmirësime, mirëpo ende kërkohet të forcohen kontrollet për raportim menaxherial dhe llogaridhënie.	
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për rekomandimet e AB dhe të kërkoj nga bartësit përgjegjës ku janë dhënë rekomandimet, që në formë formale të raportojnë mbi zbatimin e atyre rekomandimeve.		Menaxhmenti vetëm për një numër të caktuar të raporteve të auditimit ka bërë planin e veprimit të zbatimit të tyre.	
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj stafin e mjaftueshëm dhe të gjejë forma ligjore që të kryhen inspektimet në të gjitha fazat e ndërtimit, siç kërkohet me ligjin mbi ndërtimin. Në të kundërtën, duhet të analizoj mundësinë që këto shërbime t'i mbuloj nga inspektorët e komunave më të afërta.			Nuk janë marrë masa.

3.1.2 Paga dhe Mëditje	Kryetari duhet të bëjë riorganizim formal dhe adekuat të stafit sipas kërkesave ligjore dhe kompetencës profesionale, në mënyrë që i gjithë personeli të paguhet dhe të menaxhohet nga drejtoritë përkatëse të komunës.	Po		
3.1.2 Paga dhe Mëditje	Kryetari duhet të siguroj se gjatë përzgjedhjes së kandidatëve (rekrutimit) janë përmbushur kërkesat ligjore në mënyrë që përzgjedhje e kandidatëve të jetë objektive, profesionale dhe adekuate për pozitën e kërkuar.	Po		
3.1.2 Paga dhe Mëditje	Kryetari duhet t'i rishikoj nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta, në veçanti kur këto kontrata ndërlidhen me pozita menaxheriale. Kjo çështje duhet të shqyrtohet dhe nevojat për staf shtesë për pozitat e rregullta të parashikohen me rastin e planifikimeve buxhetore.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të rishikoj kontratën për parapagimin e shërbimeve ndaj OE dhe të siguroj se kontratat e tilla do të kenë mbështetjen sipas procedurave përkatëse ligjore.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet t'i rishikoj nevojat për angazhim permanent dhe pozitë të rregullt pune për avokatin e komunës dhe t'i forcoj kontrollet lidhur me angazhimin dhe monitorimin e shërbimeve të ofruara.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallra dhe Shërbime	Kryetari i komunës duhet të siguroj që para nënshkrimit të kontratës të ketë zotimin e plotë të mjeteve, në mënyrë që të ketë në dispozicion mjetet për realizimin e plotë të projekteve dhe planeve të saj.		Kishte progres në zotimin e mjeteve, këtë e reflekton edhe zvogëlimi i obligimeve, mirëpo ende pagesa direkt nga thesari për shkak të mos zotimit me kohë.	

3.1.4 Subvencione dhe Transfere	Me rastin e përzgjedhjes së operatorëve për shërbime, Kryetari duhet të zbatoj kërkesat e rregulloreve të prokurimit në mënyrë që konkurrenca e tregut t'i përcaktoj çmimet e shërbimeve dhe cilësinë e tyre dhe të shtoj kontrollet e duhura për shpenzimin e parasë publike.	Po		
3.1.4 Subvencione dhe Transfere	Me rastin e ndarjes së subvencioneve, Kryetari duhet zbatoj të gjitha kërkesat e rregullores së brendshme për subvencione dhe të siguroj se subvencionet ndahen vetëm për qëllimet dhe kriteret e përcaktuara, si dhe të raportohet në detaje për shfrytëzimin e mjeteve nga përfituesit.	Po		
3.1.4 Subvencione dhe Transfere	Kryetari duhet të konsideroj mundësinë e plotësim/ndryshmit të rregullores ekzistuese në mënyrë që të përcaktohen qartë kriteret (limitet) e dhënies së subvencioneve për përfituesit e njëjtë, në mënyrë që mundësia e përfitimit të tyre të jetë më gjithë përfshirëse.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se është pranuar raporti mbi shërbimet e kryera sipas marrëveshjes për projektin e bashke financiar, dhe të siguroj që pagesat për punë/shërbime të kryhen sipas rregulloreve financiare për shpenzimin e parasë publike.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të analizoj shkaqet pse në rastin e mësipërm kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë dhe të siguroj që zhvillimi i procedurave të prokurimit në të ardhmen të bëhen konform kërkesave të përcaktuara në mënyrë që të shpërblehen me kontratë OE të përgjegjshëm dhe më të favorshëm.	Po		

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të inicioj procesin e hartimit të rregulloreve të brendshme për regjistrimin e pasurive dhe të siguroj se janë zbatuar të gjitha kërkesat dhe procedurat për inventarizimin e plotë dhe vlerësimin e pasurisë së komunës në fund të vitit. Raportet dhe rezultatet e inventarizimit duhet të përfundohen dhe të inkorporohen në PFV.		Është themeluar Komisioni për vlerësimin e pasurisë, mirëpo për shkak të mungesës së stafit profesional, ky proces ende nuk ka përfunduar.	
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj vendosjen e procedurave të brendshme për identifikuar dhe kalkuluar saktë në llogaritë individuale shumat e detyrimeve të qytetarëve ndaj komunës, dhe sa më parë të aplikoj ligjin për faljen e borxheve.			Nuk janë marrë masa
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të konsideroj që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtoj obligimet e mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e obligimeve, si dhe të caktoj politika konkrete për parandalimin e hyrjeve në obligime të reja.		Krahasuar me vitin e kaluar kishte një progres në zvogëlimin e obligimeve, megjithëse edhe më tutje një vlerë të konsiderueshme të ishin bërë direkt nga thesari.	

Shtojca III: Letër e Konfirmimit

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Graçanicës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Srdjan Popovic

Kryetar i Komunës së Graçanicë,

Data: 04.05.2018, Prishtinë,



POTVRDNO PISMO

O saglasnosti sa nalazima Generalnog Revizora na Izveštaju revizije za 2017 godinu kao i za sprovođenje preporuka

Za: Nacionalnu Kancelariju Revizije:

Poštovani,

Preko ovog psima, potvrđujem da:

- sam primio nacrt izveštaja Nacionalne Kancelarije Revizije o Reviziji Finansijskih Izveštaja Opštine Gračanice za godinu završno sa 31 decembrom 2017 (u daljem tekstu "Izveštaj");
- se slažem sa nalazima i preporukama i nemam neki komentar u vezi sa sadržajem izveštaja; i da ću
- u roku od 30 dana od prijema Završnog izveštaja, dostaviti akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će uključiti vremenske rokove i osoblje koje je odgovorno za njihovo sprovođenje.

g. Srdjan Popović 

Gradočelnik Opštine Gračanice,

Datum: 04.Maj.2018, Priština,